Vendim nr. 336, datë 20.10.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 20.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (Dh) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **DHIMITËR STRATI,** i përfaqësuar nga avokati Fuat Zotaj, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 2730, datë 28.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, vetëm për pjesët e rrëzuara të kërkesëpadisë; nr. 100, datë 21.02.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë, për pjesën që ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 00-2026-262, datë 28.01.2026 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ),* si dhe Protokolli nr.1 i saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është një nga trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit Pandeli Strati, sipas dëshmisë së trashëgimisë. Në datën 27.10.1915, sipas notave të transkriptimit, Pandeli Strati, së bashku me vëllain e tij Jani Stratin dhe me kunatin e tyre Llambi Çilin kanë blerë së bashku një sipërfaqe toke prej 15 vretenësh (njësi matëse e vjetër) nga një shtetas tjetër, nën një çmim prej 27.000 groshësh (emërtim i vjetër i parasë). Trashëgimtarët e familjes Strati i janë drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave *(AKKP)* për kthimin dhe kompensimin e pronës së tyre dhe kjo e fundit, me vendimin nr. 1249, datë 10.11.2011, ka vendosur deklarimin e mungesës së juridiksionit administrativ për shqyrtimin e kësaj kërkese. Në këto kushte, kërkuesi, duke pretenduar se pronat pasuri të paluajtshme objekt padie janë në bashkëpronësi të tij dhe të bashkëtrashëgimtarëve Strati - Çili, ka paraqitur kërkesëpadi përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

2. Nëpërmjet padisë së tij, kërkuesi ka paditur trashëgimtarët e tre familjeve të tjera të cilat zotëronin tituj pronësie në të njëjtën pronë të pretenduar nga ai, disa shoqëri tregtare, AKKP-në, si dhe Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë *(ZRPP-ja Vlorë)*, duke pretenduar anulimin dhe kundërshtimin e disa vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë *(KKKP-ja Vlorë)*, shpalljen e pavlefshmërisë absolute të kontratave të lidhura mes palëve të paditura, detyrimin e ZRPP-së, Vlorë që të fshijë nga regjistrat pronësinë e familjeve të paditura, si dhe regjistrimin e kërkesëpadisë së tij.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 2370, datë 28.10.2013, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë duke detyruar dy nga familjet dhe trashëgimtarët respektivë të njohin pronarë dhe t'u kthejnë pronën kërkuesit dhe trashëgimtarëve të tjerë të familjes Strati – Çili, kthimin në natyrë trashëgimtarëve ligjorë të ish-pronarëve Strati - Çili të pasurisë të paluajtshme me sipërfaqe 6010 m^2, me pronësi shtet, detyrimin e ZRPP-së, Vlorë të fshijë regjistrimet e pasurive, titujt e të cilave u anuluan, si dhe detyrimin e saj të regjistrojë këto pasuri në emër të bashkëpronarëve Strati-Çili. Gjithashtu, ajo gjykatë në pikën 2 të dispozitivit të vendimit ka disponuar për rrëzimin e padisë lidhur me kërkimet për anulimin e vendimit nr. 82, datë 06.07.1995 të KKKP-së, Vlorë (për trashëgimtarët e një prej familjeve të paditura), si të pabazuar në prova. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim, ndër të tjerë, edhe kërkuesi për pikën 2 të dispozitivit të tij.

4. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 100, datë 21.02.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit gjyqësor nr. 2370, datë 28.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për disponimin në pikën 2 të tij, prishjen e vendimit të mësipërm, për pjesën tjetër të disponimeve, si dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me tjetër trup gjykues. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs, ndër të tjerë, edhe kërkuesi

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2026-262, datë 28.01.2026, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile *(KPC).*

6. Në datën 08.06.2026 (sipas shërbimit postar), kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 22.06.2026. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

7.1. *Parimi i gjykatës së caktuar me ligj i lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe me të drejtën e pronës,* pasi gjykata e apelit në tejkalim të kompetencave të saj dhe në kundërshtim me parashikimet e neneve 123 dhe 465 të KPC-së e ka kthyer çështjen për rigjykim në mënyrë të panevojshme, ndërkohë që kishte mundësinë ta zgjidhte vetë çështjen e të dilte me vendim përfundimtar, duke qenë që cilësimi juridik i natyrës së mosmarrëveshjes mund të bëhej edhe në atë shkallë. Po kështu, i gabuar është edhe konstatimi i gjykatës së apelit për mosformimin e rregullt të ndërgjyqësisë.

7.2. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi arsyetimi i kufizuar i vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me një qasje formaliste, nuk ka përmbushur kriteret e vendosura nga jurisprudence kushtetuese, si dhe nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të kërkuesit me natyrë kushtetuese, duke i cenuar në këtë mënyrë të drejtën substanciale të pronës private.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

8. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund t'i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Për sa u takon kritereve kumulative, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kritereve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare *(shih vendimin nr. 112, datë 30.04.2025 të Mbledhjes së Gjyqtarëve)*.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, i përcaktuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës, Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i Ligjit Organik të Gjykatës, përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t'i drejtohet asaj.

11. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin *subsidiar* që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes të të drejtave të individit. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, kjo do të thotë se mund

të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se vendimet gjyqësore që kthejnë çështjen për rigjykim nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste, kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjykimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimin nr. 39, datë 06.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar në Gjykatë vendimet e gjykatave të zakonshme, për aq sa ato kanë disponuar në disfavor të tij, duke i rrëzuar pjesërisht padinë dhe duke i kthyer për rigjykim këto kërkime. Konkretisht, gjykata e apelit ka prishur pjesërisht vendimin e gjykatës së shkallës së parë që kishte pranuar padinë e kërkuesit duke e kthyer një pjesë për rigjykim në atë gjykatë, ndërkohë që për rekursin e kërkuesit Kolegji Civil ka vendosur mospranimin e tij, duke e konsideruar të drejtë vendimin e gjykatës së apelit për kthimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë.

13. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se në rastin në shqyrtim nuk rezulton që kërkuesi të ketë parashtruar ndonjë argument bindës se kthimi i çështjes për rigjykim të ketë sjellë pasoja të drejtpërdrejta në të drejtat kushtetuese të tij, të cilat nuk mund të riparohen gjatë procesit që do të zhvillojnë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Për rrjedhojë, në kushtet kur çështja është kthyer për rigjykim dhe procedurat gjyqësore për shqyrtimin e çështjes nuk kanë përfunduar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, kërkuesi ka ende mjete ligjore në dispozicion për të paraqitur pretendimet e tij për të drejtat që pretendon se i janë shkelur, prandaj ankimi kushtetues individual që lidhet me vendimin objekt kundërshtimi nuk plotëson kriterin për *shterimin e mjeteve juridike efektive*.

14. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

15. Nisur nga sa më sipër, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.